



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 12.11.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen me objekt: Ankim kundër vendimit nr. 702, datë 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Agron Bushati.
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtrohet si vijon:

1. Për procedimin penal me nr. * , viti 2003**, në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit i qëndrojmë parashtrimeve të shprehura në seancën gjyqësore publike të datës 05.11.2025.

1.1. Nga aktet në dosje të Komisionit ka rezultuar se Prokurori i Përgjithshëm me urdhërin nr.41, datë 08.02.2008 "Për dhënie masë disiplinore" ka vendosur që prokurorit Agron Bushati për shkeljet e kryera i jepet masa disiplinore "Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) viti" duke u transferuar në këtë periudhë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë.

1.2. Në pjesën arsyetuese të këtij urdhëri rezulton se shkeljet konkrete, ku përfshihen edhe ato në *procedimin penal me nr.** , viti 2003*, janë evidentuar hollësisht në

Faqe 1 nga 4

relacionin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij dhe se këto shkelje janë pranuar nga prokurori Agron Bushati.

1.3. Marrë në konsideratë se normat ligjore në ligjin nr.84/2016 për vlerësimin e aftësive profesionale referojnë edhe te ligji nr.96/2016 “ *Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, vlerësojmë se shkeljet e subjektit të rivlerësimit në këtë procedim penal për shkak se është marrë një masë disiplinore të *çmohen* si rrethanë rënduese në kuptim të nenit 115 “Kriteret për caktimin e masës disiplinore” pika 4 gërma “a” të ligjit nr.96/2016.

2. *Për denoncimin¹ e shtetasit ***** , me objekt veprime të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kallëzimit penal me të dëmtuar denoncuesin.

2.1. Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit i qëndrojmë parashtrimeve të shprehura në seancën gjyqësore publike të datës 05.11.2025.

2.2. Pas debatit gjyqësor në Kolegj vlerësojmë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se *nuk ka nënshkruar në regjistër* për marrjen në dorëzim të kallëzimit penal të shtetasit Kolë Bjanku, nuk gjen mbështetje nga rrethanat faktike të dala nga hetimi administrativ në Komision² përse vijon:

2.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar materialet e kallëzimit penal me numër **, të vitit 2009, pas shfuqizimit të akteve të procedimit penal me nr.** , të vitit 2009 të Prokurorisë Shkodër nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme.

2.2.2. Më datë **.01.2010 Prokurori i Prokurorisë Lezhë ka marrë vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin e shtetasit **** me arsyetimin se duke patur parasysh se masa e dënimit për veprën penale “Zhdukja ose humbja e fashikullit” parashikuar nga neni 313/a i Kodit Penal pasi duke patur parasysh se masa e dënimit është në maksimum deri në pesë vjet burg, afatin kohor kur ka ndodhur vepra që është viti 2002 rezulton të jemi në kushtet e nenit 66 gërma “c” e Kodit Penal dhe për pasojë ndjekja penale për këtë vepër është shuar.

2.2.3. Vendimi i mosfillimit ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe vendimi fundor i administruar në dosjen e Komisionit është vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër me numër **, datë **.10.2012, i cili ka konstatuar situatën faktike, si vijon:

*[...] vendimi i apeluar nr.**, datë **.01.2012 i kolegjit monokratik të gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë nuk është i drejtë për çka ai duhet të priset dhe sepse ankimi i datës 23.11.2010 ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit datë **.01.2010 të prokurorit **,*** , është i drejtë, hetimet nga ky i fundit duhet të vazhdojnë.*

¹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **10.2018.

² Referojuni informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me shkresën me nr. **/* prot., datë **.04.2023 ku përcillen fotokopje të njehësura me origjinalin të dosjeve gjyqësore në emër të **** administruar në dosje të Komisionit

Kjo sepse i dëmtuari *** *** provohet se ka bërë kallëzim në muajin gusht të vitit 2002 ndaj inspektorit të policisë *** *** në seksionin SH.K.B. në komisariatit e policisë Shkodër, pranë oficerit të policisë gjyqësore *** *** veprim hetimor i konfirmuar me vendimin datë **.04.2009 të prokurorit *** *** (paragrafi II, rreshti 4-7, i pjesës konstatim në vendim) dhe me vendimin datë **.01.2010 të prokurorit *** *** (paragrafi VII, rreshti i pestë, i pjesës konstatim në vendim).

Po ashtu provohet se me shkresën nr. **, datë **.08.2002 ky kallëzim është përcjellë në Prokurorinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, dhe është marrë në dorëzim, përkundrejt nënshkrimit nga prokurori Agron Bushati, veprim hetimor i konfirmuar me vendimin datë **.09.2009 të prokurorit *** *** (paragrafi II, rreshti 7-10, i pjesës konstatim në vendim).

...Agron Bushati, me funksion publik të prokurorit, nuk ka kryer veprime që ligji, e pikërisht neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, e detyron t'i kryejë, siç është ai i shënimit në regjistrin e njoftimit të veprës penale të marrë nëpërmjet kallëzimit të mbërritur me shkresën nr. **. prot., datë **.9.2002, të Komisarariatit të Policisë Shkodër. Çka qartazi përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës së tij për "...zhvillimin, brenda kompetencave të caktuara të hetimeve të nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale" (pika 1, neni 277 i K. Pr. P.), njëri nga të cilët është edhe "regjistrimi i njoftimit të veprës penale", të cilën ai nuk e ka kryer.

Po ashtu, e hapur është edhe pasoja e "dëmtimit të interesave të ligjshme të shtetit" të disiplinimit të kryerjes së hetimeve të nevojshme për ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe i interesave të ligjshme të qytetarit *** ***, si i dëmtuar nga vepra penale e kanosjes, për procedimin e fajtorit (pika 1, neni 58 i K. Pr. P.), të cilën ai, mbi bazën e pikës 1, të nenit 283, të K. Pr. Penale, ka kallëzuar si vepër penale që ndiqet kryesisht nga Prokuroria dhe Policia Gjyqësore [...].

2.3. Në përfundim, vlerësohet se shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

3. **Për denoncimin³ me postë elektronike i datës **.9.2023 të shtetasës **.**, e cila pretendon se subjekti, nën kërcënimin e armëve të ftohta, ka kërcënuar e kanosur qytetarin në mes të qytetit shoqëruar me një video.**

3.1. Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit i qëndrojmë parashtrimeve të shprehura në seancën gjyqësore publike të datës 05.11.2025.

3.2. Pas debatit gjyqësor në Kolegj vlerësojmë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ta vlerësuar videon si brenda kufijve të intimitetit familjar nuk i përgjigjet rrethanave faktike të dala nga hetimi administrativ në Komision dhe gjatë debatit

³ Denoncim i përcjellë Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, në rrugë elektronike, me email-in e datës **.9.2023, në orën 18:13.

gjyqësor në Kolegj, pasi video-ja ka prodhuar efekte përsa kohë sikurse shprehet subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj është *ndarë privatisht mes kolegësh*.

3.3. Gjithashtu, pavarësisht rrethanave të realizimit të kësaj video, duhet të mbahet në konsideratë edhe fakti që sendet e përdorura kanë qënë prova materiale dhe janë marrë nga vëndi i ruajtjes së tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Provat materiale kanë një regjim të posaçëm për ruajtjen, administrimin dhe lëvizjen e tyre. Kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit është e një shkalle të tillë që cënon si sjelljen jashtëgjyqësore të magjistratit edhe atë që lidhet me respektimin e normave që kanë për objekt sendet e ruajtura në sekretarinë (*dhomën e provave*) të organit procedues, pavarësisht statusit të tyre si pjesë e një procedimi penal në hetim, në gjykim apo të përfunduar.

3.4. Sjellja e subjektit të rivlerësimit nuk duhet vlerësuar vetëm si shkelje jashtëgjyqësore por duhet vlerësuar edhe si sjellje në ushtrimin e funksionit pasi subjekti i rivlerësimit nuk duhet të nxirrte prova materiale jashtë vendit të ruajtjes së tyre, pavarësisht motivimit dhe qëllimit për të cilin subjekti i rivlerësimit justifikon këtë veprim.

3.5. Në përfundim, vlerësohet se shkelja e konstatuar në veprimet e subjektit të rivlerësimit, është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

4. Kërkimi i ankimit

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 03.11.2023, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 7, të nenit F të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.9.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Klodjan BRAHO